



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Nr. _____ Prot

Datë 12/10/2023

PROCES VERBAL

Konsultimi për Buxhetin dhe Paketën Fiskale 2024

Vendi : Qendra Kulturore Multifunkionale, Përmet

Ora : 18:00

Tema e konsultimit : Buxheti dhe Paketa Fiskale 2024.

I mbajtur sot më datë 12 Tetor me pjesëmarrjen e Kryetares së Bashkisë, znj. Alma Hoxha, Kryetares së Këshillit Bashkiak, znj. Anila Dhimitri, nën/Kryetarit z. Florand Hasani, Drejtoreshës së Financës, znj. Etleva Kreci, Drejtorit të Urbanistikës, z. Gerald Ilia. Të pranishëm janë një numër i lartë i subjekteve hoteliere dhe turistike. Kryetarja e Bashkisë hapi takimin duke kërkuar ide dhe sugjerime nga përfaqësuesit e subjekteve lidhur me buxhetin dhe paketën fiskale për vitin e ardhshëm. Gjithashtu ajo u shpreh e hapur për të vijuar bashkëpunimin edhe më tej si dhe informoi subjektet se tarifa vendore do të qëndrojë e pandryshuar edhe për vitin 2024.

Pas fjalës hapëse të Kryetares, subjektet vijuan me kërkesat e tyre si më poshtë :

-Rishikim i tarifës vendore për shtëpitë pritëse.

-Kërkesë për të luftuar informalitetin.

-Pagesa e dritave dhe ujtit si biznes dëmton shtëpitë pritëse.

-Rritja e investimeve në Banjat e Bënjës.

-Formalizim i biznesit të turizmit.

-Të shtohen shërbimet në këmbim të më shumë të ardhurave të cilat do të jenë investime për qytetin në vijim.

-Ndërtimi i një stacioni për makinat elektrike.

-Problematikë e vazhdueshme me hapësirat e parkimeve dhe nevoja për të patur një menaxhim sa më eficient të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Pasi subjektet shprehën kërkesat e tyre, fjalën e mori Drejtoresha e Financës, e cila sqaroi paqartësitë e të pranishmëve lidhur me tarifat vendore dhe u siguroi atyre se nga ana e Bashkisë do të bëhet maksimumi që të gjithë të jenë të barabartë në treg.

Në fund të takimit Kryetarja e Bashkisë, znj. Alma Hoxha i falenderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe u shpreh mjaft e lumtur në hapat që po meren drejt një bashkëpunimi sa më frytshëm me bizneset që operojnë. Sigurisht ajo u siguroi se institucioni i saj do të jetë gjithmonë në mbështetje të subjekteve duke i mbrojtur ata nga rreziqet e mundshme që sjell tregu. Si përfundim palët pranuan të jenë në kontakt të afërt për të qënë të informuar me çdo gjë.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Foto nga takimi:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK